



Funded by
the European Union

ARSIMI I KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN NË KOSOVË

EDITORIAL



Funded by
the European Union

EDITORIAL

Diskutimi Publik rreth Raportit

“Arsimi i Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë”

Përfshirja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin edukativo-arsimor në Kosovë ka shënuar përmirësime gjatë dekadës së fundit. Megjithatë, këto komunitete vazhdojnë të përballen me sfida të cilat manifestohen në çdo aspekt të arsimit të tyre, përfshirë shifra të ulëta regjistrimi dhe vijimi të shkollimit, rezultate të dobëta mësimore, cilësia e ulët e mësimdhënies etj. Impakti i tërësishëm i këtyre sfidave i lë fëmijët e këtyre komuniteteve pa mbrojtje dhe pa përkrahje të mjaftueshme në procesin arsimor.

Me qëllim të identifikimit të fakteve dhe analizimit të gjendjes në këtë fushë, më 21 dhjetor 2021 Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) organizoi një diskutim publik përmes platformës elektronike Zoom. Ky diskutim u zhvillua në kuadër të projektit një-vjeçar **Cilësia, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja në Arsim 2021**, i financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe i jetësuar nga KEC.

Boshti i diskutimit ishte prezantimi i një Raporti hulumtues në lidhje me arsimin e komuniteteve, i përgatitur nga eksperti i angazhuar nga projekti i lartcekur për këtë qëllim. Ky Raport ofron një qëndrim analitik dhe kritik të gjendjes në terren, mbështetur në të dhënat e mbledhura dhe një analizë të natyrës kryesisht kualitative. Autori i Raportit prezantoi të gjeturat e hulumtimit, përfshirë përshkrimin e gjendjes faktike dhe kuadrin ligjor ekzistues. Më tej ai bëri një analizë të tërësishme të situatës dhe të punës së bërë deri tani nga institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë me projekte të financuara nga donatorë të ndryshëm. Në fund, u dhanë rekomandime rreth mënyrave se si mund të përmirësohet gjendja e arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Një prej faktorëve që u theksua ishte fakti se kjo mund të arrihet me anë të ristrukturimit të kuadrit ligjor, me synim që ky proces të mos varet vetëm nga projektet jetëshkurtra por të jetë proces i vazhdueshëm e afatgjatë.

Në diskutim publik morën pjesë përfaqësues të MASHTI-t (Divizioni për Komunitete) dhe DKA-ve nga komunat ku jetojnë pjesëtarë të komuniteteve, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e arsimit të komuniteteve, Zv/Dekani i Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prizrenit, Prof. Vedat Bajrami, i cili është njohës i kahmotshëm i çështjeve të edukimit dhe gjithëpërfshirjes, si dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Fridon Lala, i cili vjen nga radhët e komunitetit egjiptian.

Zbatuar nga:





Funded by
the European Union

Gjatë diskutimeve dhe pyetje-përgjigjeve, pjesëmarrësit ngritën çështje me rëndësi, shprehën mendime të bazuara në përvojën shumëvjeçare të punës me arsimin e komuniteteve, dhe ofruan sugjerime rreth aspekteve prioritare të temës në fjalë. Disa prej këtyre pikave përfshinin:

- mungesa e të dhënave dhe pengesat në mbledhjen e informatave si faktorë që ndihmojnë në kuptimin e situatës aktuale dhe gjetjen e zgjidhjeve në vijim;
- punësimi i pamjaftueshëm i profesionistëve të kualifikuar nga radhët e komuniteteve në shkollat dhe qendrat ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- puna shtesë që duhet bërë me nxënësit më vështirësi në të nxënë dhe pengesa të tjera;
- domosdoshmëria e rishikimit dhe plotësimit të udhëzimit administrativ për qendrat mësimore;
- plotësimi i materialeve shkollore me të dhëna rreth kulturës, historisë dhe traditave të komuniteteve;
- rëndësia e përfshirjes së prindërve në jetën shkollore të fëmijëve të komuniteteve, kryesisht në aspektin e motivimit për arsim-edukim.

Raporti ka mëtuar të përfshijë thuajse të gjitha aspektet e arsim-edukimit të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, duke prekur çdo shtresë të kësaj teme.

Diskutimet publike të kësaj natyre vazhdojnë të jenë instrument i dobishëm për identifikimin e problematikës shumëdimensionale të arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. Krahas sfidave ekzistuese, pandemia e shkaktuar nga Covid-19 ka shtuar probleme të mëtejshme në aspektin e shkollimit të fëmijëve të komuniteteve. Në këtë kuadër, pritet që raporti i prezantuar në këtë takim të shërbejë si material i nevojshëm gjatë përpjekjeve të ardhshme për përmirësimin e arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

Ky editorial është hartuar nga Bora Shpuza Kasapolli në kuadër të programit “Cilësia, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja në Arsim 2021” zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë. Përmbajtja e këtij editoriali në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Zbatuar nga:

